



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:170202

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737225

**C.nr.2754/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Sh. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 579.75 euro, jashtë seance, më datë 27.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Sh. nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, për periudhën kohore nga data 01.08.2019, deri me 30.06.2022, të ia kompensoj:

1. Për periudhën kohore Gusht - Dhjetor 2019, në shumën prej 61.96 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11.06 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 187.27 euro;
4. Për periudhën kohore Janar - 30.06.2022, në shumën prej 319.64 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 579.75 € (pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia paguaj shumën prej 124.00 € (njëqind e njëzetë e katër), në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësi A.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 22.08.2022, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa përmes parashtresës së datës 03.04.2024, ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.08.2019, deri më datën 30.06.2022, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në Gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit e cila i takon paditësit është shuma në lartësi prej 579.75 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 10.05.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2019 është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 03.04.2024, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, si dhe nga Kontrata e punës numër 1408, të datës 22.09.2021, për paditësin e lëshuar nga Komuna e

Prizrenit – Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, lista e pagave EM00057182, vërtetimi me nr. protokollin 35/2, i datës 15.11.2023, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Gjimnazin “Gjon Buzuku” në Prizren, si mësimdhënës, nga data 01.09.2003, dhe vazhdon të jetë ende në marrëdhënie kontraktuale me shkollën.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësit, e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.08.2019 – 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 61.96 euro ( $459 * 2.7\% = 12.39 * 5 \text{ muaj} = 61.96 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 11.06 euro ( $459 * 0.2\% = 0.918 * 12 \text{ muaj} = 11.06 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka

qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 187.27 euro ( $459 * 3.4\% = 15.60 * 12$  muaj = 187.27 euro).

- Për periudhën 01.01.2022 – 30.06.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 319.64 euro ( $459 * 11.6\% = 53.24 * 6$  muaj = 319.64 euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës sa i përket parashkrimit të kërkesës për vitin 2019, mirëpo këtë pretendim e vlerësoi si të pabazuar, pasi që me parashtrësën e datës 05.04.2024, i autorizuari i paditësit e ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që kërkesa e paditësit është paraqitur prej datës 01.08.2019, ndërsa paditësi me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 22.08.2022, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, ka ndërprerë parashkrimin për periudhën 01.08.2019, e deri më 30.06.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 22.08.2022, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin Gusht 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin Gusht 2019, ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht i njëjti pas pranimit të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin Gusht 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht Shtator 2019, paditësi ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësit kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 459.00 euro, duke u bazuar në listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjkata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtresë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtresa gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:170202, 27.05.2024

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.